

Albanolog i njohur

## Waclaw Cimochoowski

Mr. Agim Spahiu

14 tetor 2008

### Përmbledhje

Waclaw Cimochoowski (1912-1982) është një ndër ata albanolog të huaj, të cilët tërë veprimtarinë e tyre shkencore e përqëndruan në hulumtimin dhe studimin e gjuhës shqipe

**W. Cimochoowski** i kreu studimet e larta në filologji klasike në universitetin e Vilnas (Lituani) gjatë viteve 1931-1935 dhe u specializua më tej në Vjenë pranë Joklit etj. Më 1937 qëndroi një vit në Shkodër, ku u interesua për të njohur me hollësi veçoritë e së folmes së katundit Dushman, që i parashtrroi në monografinë e tij mjeshtërore në gjuhën shqipe **Le dialecte de Dushmani** (Poznanj, 1951).

Ka botuar edhe një varg studimesh të tjera, duke dhënë ndihmesa me vlerë, ndër të tjera, edhe për problemin e prejardhjes së gjuhës shqipe<sup>1</sup>.

Në monografinë e tij **Dialekti i Dushmanit** (1951) Cimochoowski dëshmoi, ndër të tjera, se kishte studiuar thellësisht strukturën gramatike të gjuhës shqipe në përgjithësi dhe të dialektit të saj verior në veçanti. Në këtë përfundim arrihet duke gjykuar jo vetëm nga parashtrimi i saktë i fakteve të përshkruara në atë vepër shembullore, por edhe nga vërejtjet e mprehta mbi gjuhën shqipe dhe mbi dialektet e saj. Këtu poshtë po përmend dy dukuri morfologjike dhe pikërisht:

I. Në monografinë e tij (1951) Cimochoowski ka vënë në dukje se në lakimin e emrave të shqipes në përgjithësi dallohen dy tema. Ai pohon:

Duke qenë se forma e emërores njëjës ndryshon shpesh në mënyrë të ndjeshme nga e njëjta formë e shumësit, atëherë i njëjti emër paraqitet me dy tema të ndryshme...

Pra Cimochoowski është i pari gjuhëtar, që është shprehur shkoqur për praninë e dy temave të lakimit të emrave në gjuhën shqipe. Para tij është pohuar vetëm që mbaresat rasore të shumësit i shtohen formës së rasës emërore të këtij numri.

---

<sup>1</sup>Shih M. Domi, *Studime filologjike, Veprimtaria shkencore e Vaclav Cimochoovskit në fushën e albanologjisë*, SF, 1983, nr.4.

II. Risia tjetër në sistemin emëror të shqipes, që u vu në dukje nga Cimochoowski, është e karakterit dialektor. Është fjala për përdorimin e trajtës së shquar të rasave gjinore, dhanore, njëjës e shumës, e rrjedhore njëjës edhe në ato raste, ku në përgjithësi përdoret trajta e pashquar. Në të folmen e Dushmanit, sipas Cimochoowski-t, trajta e shquar e rasave gjinore, dhanore e rrjedhore përdoret edhe pas të ashtuquajturës njëje të pacaktuar **nji**, pas përemrave dëftorë dhe pas disa përemrave të pacaktuar. Sipas këtij gjuhëtari (1951, 37 v):

Për sa i takon njëjës së ashtuquajtur të pacaktuar *nji*, ajo nuk ndiqet gjithashtu veçse nga trajtat e shquara të gjinore, dhanore dhe rrjedhore njëjës të emrave mashkullorë. Më saktësisht, në këto raste në njëjës trajtat e pashquara nuk shfaqen fare në dialektin e Dushmanit. Për sa i takon gjinisë femërore, në rasën gjinore, dhanore e rrjedhore njëjës ka luhate, sidomos pas përemrit *ai* ndeshen si trajtat e pashuara ashtu edhe të shquarat

**Marrë nga: Shaban DEMIRAJ, Gjuha shqipe, *Probleme dhe disa figura të shquara të saj*, Tiranë, 2003, f. 161, 162, dhe 164.**

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në vitin 2004 ia ka botuar veprën **Për gjuhën shqipe / Pour la langue albanaise** nga Botime të veçanta LI, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 23, Prishtinë, 2004, ff. 486 17x24 cm. ISBN 9951-413-10-2; Parathënia nga R. Ismajli, ff. 7-19. Redaksia: Idriz Ajeti, Besim Bokshi, Rexhep Ismajli.

Përmban: *E folmja e Dushmanit; Kërkime mbi historinë e sand'hit në gjuhën shqipe; Prejardhja e gjuhës shqipe; Pozicioni gjuhësor i ilirishtes ballkanike në rrethin e gjuhëve indo-evropiane; Kërkime mbi toponiminë shqiptare; Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-sllave; Formimet e kohës së tashme të shqipes me io e nio; Rreth fjalëformimit në gjuhë shqipe; Etymologische Miscellen; Etimologji shqipe; Shqipja mbarë; Dy etimologji shqipe; Albanologjia në Poloni; Për studimet e Idriz Ajetit; Gjuha shqipe.*

Përkthyen: Murat Bejta, Nexhibe Palloshi, Rexhep Ismajli, Irena Sawicka, Jolanda Mindak.

**Pjesa e fundit, marrë nga <http://www.ashak.org/index.php?cid=1,39>**